



Pranimi / Dorezimi Priljepe / Predato Received / Delivery		04-06 2021		viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Priljepe Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOPSHTIK	2889/2021		114	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.385/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1649/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 29.04.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.857/2018 të datës 28.12.2018 të parashtruar nga ankuesi ne adresë Banimi: Fshati Barainë, Komuna e Podujevës, kundër Vendimit me Nr.538/2018 të datës 05.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 04.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A.nr.857/2018 e datës 28.12.2018 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr.538/2018 i datës 05.12.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës. **Anulohet** procedura e rekrutimit për pozitën “Inspektor i Pylltarisë” në Komunën e Podujevës si dhe të gjitha vendimet e tjera që rrjedhin nga kjo procedurë.
- III. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Podujevës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Podujevës në bazë të autorizimit të datës 11.09.2018 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti të Administrimit të Shërbimit Civil, me datë 13.09.2018 ka shpallur konkursin për pozitën “Inspektor i Pylltarisë”. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë) por që nuk është përzgjedhur si kandidat i suksesshëm në këtë pozitë. Komuna e Podujevës më datë 12.11.2018 ka publikuar njoftimin me numër Nr.13-111/01-88937/18 për kandidatin e suksesshëm, ndërsa ankuesi kundër këtij njoftimi më datë 13.11.2018 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 13-112/12-0089313/18 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës, më datë 05.12.2018 merr vendim me numër Nr.538/2018 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit kundër njoftimit për përzgjedhjen e kandidatit për vendin e punës “Inspektor i Pylltarisë”, sipas konkursit të datës 13.09.2018.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin me numër Nr.538/2018 të datës 05.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës, më datë 28.12.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 8026/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 09.01.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Podujevës. Komuna e Podujevës më datë 23.01.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 28.12.2018 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.01.2019; Përgjigjen në kërkesë të datës 23.01.2019; Ankesa e ankuesit e datës 13.11.2018 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Podujevës; Vendimi i datës 05.12.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Podujevës; Formulari për kërkesën e datës 20.09.2018; Kërkesa për punësim e kandidatit me dokumentacionin e bashkangjitur; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Çertifikatën e lindjes së ankuesit të datës 19.09.2018; vërtetim i noterit me numër LRPnr.476/2018; Diplomën e ankuesit të datës 04.09.2017 me numër 47; Çertifikatën e datës 30.12.2001; Çertifikatën e vitit 2006 lëshuar nga AutoCAD LT; Çertifikatën e datës 13.01.2007; Çertifikatën e datës 07.01.2005; Çertifikatën e datës 20.03.2015; Konfirmimin e datës 24.03.2021; Çertifikatën e datës 09.09.2000; Çertifikatën e datës 01.09.1998; Çertifikatën e datës 13.03.2001; Aktvendimin mbi licencën e mësimdhënësit të datës 13.06.2013; m Letë rekomandimin e datës 10.07.1997; Çertifikatën e datës 01.11.1997; Konfirmimin e datës 31.12.1995; Konfirmimin e datës 04.10.2001; Konfirmimin e datës 23.11.2001; Konfirmimin e datës 30.04.2002; Vërtetimin e datës 25.01.2018; Letër rekomandimin e datës 27.03.2014; Çertifikatën e Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 19.09.2018; Diplomën e ankuesit të datës 12.07.2011 me Nr:89; Diplomën e ankuesit të datës 20.07.2004 me numër:150; CV-në e ankuesit; Formularin për Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj (Form.MAP-SHCK-08a); Testi me shkrim i ankuesit i datës 24.10.2018; Njoftimi i datës 12.11.2018 për kandidatin e suksesshëm; Raporti final i rekomandimit i datës 12.11.2018 nga Komisioni Rekrutues; Formulari për Renditjen përfundimtare e kandidatëve (Form.MAP-SHCK-10) i datës 15.10.2018; Formulari për përmbledhjen e vlerësimeve individuale (Form.MAP-SHCK-09); Njoftimi i datës 05.11.2018 me numër 13-472; Formularin për Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj (Form.MAP-SHCK-07); Formulari për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë (Form.MAP-SHCK-05); Akt emërimi i datës 01.07.2015; Njoftimi i datës 23.10.2018 me numër 13-460; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar gjatë datës prej 13.09.2018 deri me datë 27.09.2018; Vendimi për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil i datës 12.10.2018; Konkursi i datës 13.09.2018; Autorizimin e DASHC/MAP të datës 11.09.2018; Formulari për kërkesë i datës 14.09.2018; Kërkesa për punësim e kandidatit të pranuar e datës 14.09.2018; Ekstrakti i lindjes i kandidatit të pranuar i datës 14.09.2018; Kopjen e letërnjoftimit; Çertifikatën e datës 08.07.2015 me numër reference:2153/15 lëshuar nga Kolegji i Menaxhmentit Internacional Globus; Diploma e datës 20.07.2017 me numër:053/17; Shkresën e noterit me numër rend:6324/2017; Vërtetimin e datës 21.09.2018; Formularin për Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj (Form.MAP-SHCK-08a) për ankuesin; Testin me shkrim i kandidatit të përzgjedhur; Kërkesën e ankuesit të datës 13.06.2019; Njoftimin e datës 17.06.2019; Aktgjykimin A.nr.1649/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 29.04.2021; Përgjigjen e menaxherit të Personelit të Komunës së Podujevës të datës 02.07.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që procedura e rekrutimit për pozitën “Inspektor i Pylltarisë”, është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe janë zgjatur procedurat e rekrutimit, Komisioni Përzgjedhës ka qenë i pa kompletuar, dhe po ashtu, citoj “kandidati i përzgjedhur e ka të përfunduar kolegjin Globus në Podujevë, drejtimi i ndërvarësisë që nuk është aspak i përafërt me fakultetin e kërkuar”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shqyrtimit të dokumentacioneve të dërguara nga organi i punësimit, ka konstatuar se konkursi për pozitën “Inspektor i Pylltarisë” i shpallur nga Komuna e Podujevës me datë 13.09.2018 dhe është mbyllur më datë 27.09.2018, ndërsa lista e shkurtër nga Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil është përgatitur më datë 15.10.2018 me çka nënkuptohet se lista e shkurtër është përgatit jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 26 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: “Përgatitja e listës së shkurtër zhvillohet brenda pesë (5) ditëve të punës pas afatit të fundit të përcaktuar në shpalljen e rekrutimit”, po ashtu lista e shkurtër është përgatitur edhe jashtë afatit të përcaktuar për pritjen e postës nëse ka ndonjë aplikacion ashtu siç përcaktohet në nenin 116 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “1. Njoftimi me postë bëhet nëpërmjet postës së zakonshme apo të certifikuar. 2. Një shkresë e dërguar me postë, të zakonshme apo të certifikuar, për qëllim të këtij Ligji, do të vlerësohet e njoftuar në ditën e pestë nga data e dorëzimit të shkresës në postë, për adresat brenda Republikës së Kosovës, dhe ditën e shtatë, për adresat jashtë territorit të vendit”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe gjitha provat e lëndës, ka konstatuar që sipas autorizimit të Ministrisë së Administratës Publike/Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil i datës 11.09.2018 kriteret e konkursit janë miratuar si në vijim: “Diplomë Universitare, Fakulteti i Bujqësisë, ose ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me vendin e punës dhe tri (3) përvojë pune profesionale”, ndërsa të njëjtat kriteret janë publikuar edhe në konkursin e shpallur nga Komuna e Podujevës me datën 13.09.2018, mbi këtë bazë Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në kriteret e konkursit dhe gjatë administrimit të provave ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur posedon Çertifikatën e lëshuar nga Kolegji Globus me datë 08.07.2015 me numër reference:2153/15, me të cilën dëshmohet se kandidati i përzgjedhur me datë 08.07.2015 ka përfunduar studimet themelore Bachelor në Programin Menaxhment Gjeneral Internacional, rrjedhimisht kualifikimi i kandidatit të përzgjedhur nuk është i përafërt me specifikimin e autorizimit të Ministrisë së Administratës Publike/Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil dhe konkursit të shpallur nga Komuna e Podujevës për pozitën “Inspektor i Pylltarisë”, ku specifikisht për pozitën në fjalë kërkohet “Diplomë Universitare, Fakulteti i Bujqësisë, ose ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me vendin e punës”, kështu që Komisioni Përzgjedhës Ad-Hoc i Shërbimit Civil për Zhvillimin e Procedurave të Rekrutimit, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: “Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: arsimimi dhe kualifikimi profesional”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në mandatin ligjor, ka shqyrtuar në tersi procedurën e rekrutimit për pozitën “Inspektor i Pylltarisë” të shpallur nga Komuna e Podujevës dhe ka konstatuar që Kryetari i Komunës së Podujevës më datë 12.10.2018 ka nxjerr Vendim me Nr.prot: 02-020/04-0082703/18 me të cilin ka bërë emërimin e Komisionit Përzgjedhës në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, ku në bazë të Formularit Form. MAP-SHCK-07 janë përshkruar edhe pozitat e anëtarëve të komisionit si në vijim:

- | | | | | |
|----|--|----|--|----|
| 1. | -Inspektor i tregut- anëtar; | 2. | -Zyrtar për Pylltari 1- kryesues; | 3. |
| | Udhëheqëse e Sektorit për Inspektive- anëtare; | 4. | Udhëheqëse e Sektorit të Buxhetit dhe | |
| | Financave, anëtare dhe 5. | | Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi-anëtar. | |

Në këtë kuptim Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar këtë përbërje të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, ka konstatuar se tre (3) anëtarë të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil (Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Udhëheqës i Sektorit për Inspektive) mbajnë pozita më ta larta se pozita që rekrutohet, një (1) anëtar i Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil (Inspektor i tregut) mban pozitë të njëjtë me pozitën që rekrutohet ndërsa një (1) anëtar i Komisionit Përzgjedhës



të Shërbimit Civil (Zyrtar për Pylltari 1) mbanë pozitë më të ulët se pozita që rekrutohet, në këtë rast ky komision është themeluar në kundërshtim me nenin 7 paragrafin 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Institucionet themelojnë një Komision përzgjedhës ad hoc të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: KPSHC), i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHC përbëhet nga anëtarë të cilët kanë pozita më të lartë se pozita që duhet të rekrutohet, po një anëtar mund të ketë pozitën e njëjtë, të jetë shumetnik dhe me përfaqësim gjinor”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën “Inspektor i Pylltarisë” të shpallur nga Komuna e Podujevës është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”* dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.538/2018 të datës 05.12.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafi 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari të Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.385/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

